

ERIC-EMMANUEL SCHMITT

ELIKSIRI I DASHURISË

ROMAN

BOTIMET TOENA

ERIC-EMMANUEL SCHMITT

ELIKSIRI I DASHURISË

roman

Përktheu nga origjinali frëngjisht
Edit Dibra

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2016

Autori: Eric-Emmanuel Schmitt (Erik-Emanyel Shmit)
Titulli në origjinal: L'Élixir d'amour
Botoi në frëngjisht: Albin Michel

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Anrila Spahija
Korrektore letrare: Petrina Ago
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Ana Shema

ISBN 978-9928-205-61-2

© Editions Albin Michel-Paris 2014

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

Botimet TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

ELIKSIRI I DASHURISË

Luizë,

Nëse më dëgjon, përshëndetje.

Nëse nuk ma ke ngenë, lamtumirë.

Varet nga ti nëse kjo letër do të shënojë fillimin ose fundin e letërkëmbimit tonë.

Para meje po ngrihet një diell i venitur dhe unë sodis Parisin, të cilit tetori i ka dhënë zbehtësinë e një kafshe të sëmurë, të trazuar nga gjethet e rëna, të bezdisur nga trafiku i zhurmshëm, të etur për një qeti që po vonon. Mezi po pret dimrin. Molisja e verës po fanitet dhe qyteti mezi pret t'i kthehet moti i ftohtë, i thatë e i qashtë. Dy stinë janë boll për një qytet: zagushia dhe acari.

Luizë, le ta shndërrojmë pasionin tonë të lënduar në një dashuri të patrazuar. Më beso, gjatë këtyre viteve të fundit, nuk kam çmuar te ti thjesht lëkurën, kofshët a përqafigmet tona, të kam adhuruar për atë që

ELIKSIRI I DASHURISË

je, për mendjemprehtësinë tënde, përgjigjet në majë të gjuhës, shakatë, dallditë e tua. Përse ta humb këtë mrekulli për shkak të largësisë? Mos jam i dënuar të të humbas? Mos seksi ishte e vetmja rrugë për te ti?

Përkundrazi, refuzoj çdo mesazh që pikon helm zhgënjimi, të lyrosur me lutje për dhembshuri apo me spazma gjenitale, si ajo paçavurja e mëngjesit të sotëm, e përlotur, hysterike, vaginale që më zuri ekranin e kompjuterit, të cilën e flaka në kosh duke shtypur butonin “Fshij”. Lidhja jonë ka marrë fund, Luizë, kuptoje, mos e moho. Nuk do të flemë më bashkë dhe që sot e tutje, do të jetojmë mijëra kilometra larg njëri-tjetrit.

Kur mbyllet një shteg, një tjetër hapet. Nga dashnorë, le të bëhemi miq. Pse jo? Midis nesh nuk ka pasur ende miqësi.

Të lutem, mos i prish kujtimet tona të bukura duke uruar që të mos kishin ekzistuar kurrë.

Adami

ELIKSIRI I DASHURISË

Adam,

Nëse miqësia është varri i dashurisë, e urrej
miqësinë.

Luiza

ELIKSIRI I DASHURISË

E shtrenjta ime Luizë,

Vetëm lëkura e ndan dashurinë nga miqësia. Një fije floku...

Adami

ELIKSIRI I DASHURISË

Të duket pak? Mua më duket një mur.

Luiza

Luizë,

Lëkura lodhet, shpirti jo. Fakti që trupat tanë tërhiqen më pak, që kofshët tona nuk digjen më nga dëshira për t'u kapërthyer, që seksi im struket pranë tëndit, pa e kërkuar si dikur në vitet e para të lidhjes sonë, s'do të thotë që mendja ime të ka përzënë larg, përkundrazi. Vetëm sot për shembull, po mendoja të të tregoja qyfyret e ditës, doja të flisja me ty për librin, filmin apo muzikën që kam zbuluar së fundmi, të bëja pyetje - përgjigje, të falja buzëqeshje, psherëtima, britma habie; me pak fjalë, ne s'jemi ndarë kurrë.

Në të vërtetë, mendoj se epshi është sipërfaqësor po aq sa lëkura që ai përdor. Por vendi yt është përtej spazmave. Më je ngulitur fuqishëm në mendje, më shumë se ç'do të bënte thjesht një fizik i bukur, je skalitur në përfytyrimin tim, në të ardhmen, kujtimet.

ELIKSIRI I DASHURISË

Ndryshe nga lëkura që plaket, rrudhet, rreshket, shpirti forcohet. Miqësia është vazhdimi i natyrshëm i një dashurie të vërtetë. S'mendoja se do fyheshe duke ta ofruar.

Adami

ELIKSIRI I DASHURISË

Adam,

Çdo lëshim më rëndon. Miqësia pas dashurisë do të më poshtëronte. Ta këmbej pallatin gjigant të pasionit me një qoshk të ngrohtë nuk më tundon, më mirë të dal në mes të katër rrugëve.

Mirupafshim.

Luiza

Luizë, Luizë, Luizë...

Bisha ime, e harbuara ime, po nxjerr kthetrat!
Gjithçka ose asgjë? Luizën e plotë ose pa Luizën?
Zjarr ose hi, s'e honeps prushin...

Ç'marrëzi e mrekullueshme!

Marrëzi gjithsesi...

Të pëlqen absolutja, por ky idealizëm çon në fatkeqësi. Ambiciet e tua do të ushqejnë zhgënjimin tënd. Sa më shumë të hash, aq më shumë të shkon goja lëng. Nëse ajo që përjeton duhet të jetë e përkryer, e plotë e njëherësh unike, më mirë mos jeto fare. Asnjë marrëdhënie s'do të jetë në lartësinë e ëndrrave të tua: do të gjesh dashurinë e ëndërruar, askurrë dashurinë e vërtetë.

Oh, jam në merak për ty, Luizë... Më ngjan se po del nga kjo lidhje si një vejushë që dëshiron t'ia zgjasë jetën çfytit nëpërmjet vuajtjes. Mos mendon se vuajtja

ELIKSIRI I DASHURISË

është vazhdimi i pasionit? Mos mendon ta veshësh
jetën me të zeza? S'të njoh më.

Ish i dashuri yt, miku yt gjithsesi,

Adami

ELIKSIRI I DASHURISË

Luizë,

Po më mban mëri?

Më urren?

Më ke harruar?

Adami yt

ELIKSIRI I DASHURISË

Luizë,

Të lutem përgjigjmu, qoftë dhe duke më sharë.

Po nuk m'u përgjigje, nesër marr avionin.

Adami

I dashur Adam,

Oh, sa më ka dëfryer letra jote!

Pra unë mohuakam ndarjen tonë? Fudullëku të ka verbuar... Mos harro që të lashë unë.

Pa pyetur askënd, futa një oqean midis nesh; shtëpinë, rrobat, klimën, gjerësinë, gjatësinë gjeografike, ndryshova gjithçka pa m'u dridhur qerpiku që të ndiqja yllin tim. Ti jeton në Paris, unë në Kebek.

Unë vejushë? E pashpresë? Të gënjen mendja Adam, nëse pandeh se nuk e përballoj dot ndarjen, që kam mbetur pa frymë, e gjymtuar... Nga ne të dy, ti je më i çarmatosuri para këtij fakti, aq sa më je bërë ferrë, më mbyl me përkujdesjet e tua, makthet, vetminë tënde, aq sa më duhet t'i duroj mendimet e tua të përditshme duke u ankuar për përgjigjet e mia fjalëpakta.

ELIKSIRI I DASHURISË

S'kam shumë kohë për ty, i dashur. Mos harro se sapo kam ardhur në Monreal dhe më duhet të merrem me shumë gjëra - dokumentet, taksat, të marr një shtëpi me qira, mobilimi. Sigurisht, dhoma e avokatëve që më ka marrë në punë më ndihmon, por më ka besuar që tani klientë dhe më duhet të studioj dosjet e tyre. Njëzet e katër orë mbarojnë sa hap e mbyll sytë.

Megjithatë, sonte do të ulem para kompjuterit dhe do të gjej ca minuta për ty.

Po, pasioni ynë pesëvjeçar ishte i fuqishëm si një stuhi, s'kisha provuar kurrë një lidhje të atillë, shkrirje trupash, shpirtrash, gojësh, duarsh, dëshirash, mendimesh. Një dalldi e tillë më bindi që lidhja jonë do të zgjaste: ato shkëndija paralajmëronin zjarrin e përjetësisë. Vajmedet, u zhgënjeva... Filluam ta dëshirojmë më pak njëri-tjetrin, ti i pari, unë pas teje, më pas fillove aventura sheshit me gra të tjera. Oh, nuk të qortoj për sinqeritetin tënd, ai më kurseu kohë; disa dashuri vdesin nga dyshimi, e imja vdiq nga siguria. Ndaj të lashë.

Ndarja jonë më shkatërroi, por largimi më ka qetësuar. Sa më e fortë të jetë lidhja, aq më e ëmbël bëhet ndarja. Nuk ia dimë vlerën ndarjeve; një divorc vlen po aq sa një lidhje, sepse shënon një zgjedhje

jete. Tani jam qetësuar shumë, e pranoj, pasi pasioni dashuror ka diçka poshtëruese, të cilën jam e kënaqur që e kam hequr qafe.

Më në fund vetëm. Më në fund e lumtur.

Që pas shpërnguljes, letrat e tua kanë mbetur te pragu i jetës sime, si lajmëtare të mekura të një bote të shkuar, të vjetruara si kartolinat që humbin rrugës, me ngjyra të zbërdhulëta, gati të fshira.

Çuditërisht, mbrëmja te *Sheshi i Arteve* më zgjoi dëshirën për të të shkruar. Merre me mend, po luanin *Eliksiri i dashurisë*, veprën që para pesë vjetësh, tek Opera e Parisit, na dha mundësinë të njiheshim, falë Paolës dhe Frederikut, miqve tanë të përbashkët.

Thellë meje, diçka idiote, e përvajshme, e molisur donte të shkrehej në lot me zgjimin e atij kujtimi..., por as mall, as ndonjë lot tinëzar, me përjashtim të tenorit që iu desh të përsëriste për së dyti “*Una furtiva lacrima*”¹. Në vend që të përdëllehesha, po mendoja për thelbin e historisë: si lind dashuria?

Besoj që të kujtohet se si në aktin e parë, Adina, fshatarja e bukur, lexon një legjendë, sipas të cilës një pije magjike lidhi një çift të rinjsh, Tristanin dhe

¹ “Një lot tinëzar”, arie nga akti i dytë i operës së Gaetano Donizetit, “Eliksiri i dashurisë” (shën. i përkth.).

ELIKSIRI I DASHURISË

Izoldën. A ekziston një pije e tillë? Në skenë, shishja që batakçiu i shet ngatërrestarit Nemorino ka veçse pak verë Bordo, por më bren kjo pyetje. A ka një mënyrë për të ndezur pasionin?

Qetësohu, nuk e dua këtë “*eliksirin e dashurisë*” për vete ose për t’ia hedhur dikujt në gotë - ty apo dikujt tjetër; është thjesht një mënyrë për të kuptuar thelbin e ndjenjës. A është dashuria një proces fizik, kimik, një pleksje molekulash që mund të krijohet me mjete shkencore? Apo është një mrekulli shpirtërore?

Ti doje miqësinë... E po mirë, le ta fillojmë miqësinë duke medituar për dashurinë.

Luiza

E dashur Luizë,

Përgjigjja jote më lehtësoi, sepse kisha frikë.

Ikja jote si era me shiun, letra që më luste të bashkoheshim, pastaj ftohja jote pas përgjigjes sime, më bënë të mendoja që po i përdor të gjitha energjitë e tua vetëm për t'u trishtuar. Falë zanatit, kam njohur shumë paciente të cilat, pas ndarjes, vuajtja kthehet në zakon, tret ndjesitë e tjera, pengon kënaqësitë e reja, ndryshon mënyrën se si e shohin jetën aq sa kjo u duket e padurueshme. Këto gra kridhen në orgji dhembjesh, ku me vetëdije, përpiqen të vuajnë, të vuajnë sa më shumë që të jetë e mundur. Vërtet nuk e vrasin veten, por jeta u shkon në një zyrtësi të pandërprerë, në gangrenë, kancer.

Ndërsa ti i nxjerr dhëmbët përherë - gjë që më pëlqen. Ngulmi kthetrat e tua.

ELIKSIRI I DASHURISË

Po i përgjigjem njërit prej komenteve të tua, atij ku përmend pabesinë time.

Burrat bëjnë dashuri për të arritur kënaqësinë, jo për të treguar që dashurojnë. Kur isha me ndonjë nga dashnoret e mia, nuk më pakësohej dashuria për ty, nuk më zbehej adhurimi, doja thjesht të merrja dhe të jepja kënaqësi.

Një gabim i tmerrshëm i zvetënon marrëdhëniet njerëzore: mendimi se prapanica dhe ndjenja janë i njëjti brumë. Por seksi dhe dashuria janë dy gjëra të ndryshme. Edhe pse dashuria pushton territorin e seksit, i cili, me dëshirë e lë ta pushtojë, s'ka asnjë lidhje midis epshit dhe dashurisë.

E shtrenjta ime Luizë, mendimi që fërgëlloja për ty nuk m'i zbehte nevojat, mirëkuptimi ynë i përsosur nuk sillte zbutjen e epsheve, as qetimin e fantazmave seksuale. Përse i ke marrë aventurat e mia me ca bukuroshe të rastit si një gjest fyes? Që të prekte personalisht? S'kishin kurrfarë lidhje me ty.

Do duhej të shpiknim fjalët nga e para dhe t'i ndanim ato dy botë të ndryshme, seksin dhe dashurinë, duke zhdukur çdo fjalë të përbashkët mes tyre.

Ndaj miqësia më duket një lidhje e qashtë, e pashembullt, e shndritshme, sepse është e papërlyer nga fërkimi i mishrave a bashkimi i lëngjeve. Ajo

ELIKSIRI I DASHURISË

tregon rrugën e drejtë të dashurisë. Vazhdoj të kërkoj miqësinë tënde.

Gjithë të mirat,

Adami

P.S. Pyetjes sate për “eliksirin e dashurisë”, sigurisht që do t’i përgjigjem me jo. Asnjë pije s’e zgjon pasionin. Madje, asnjë sjellje, me gjithë pretendimet e donzhuanëve apo mburrjet e bishtëpërdredhurave. Pak rëndësi ka se çfarë quajmë dashuri - epsh, apo ndjenjë - ndezja e zjarrit mbetet mister.

Adam,

Nuk e di a e ke parë.

Një paparac e kapi mat kryeministrin kanadez në krahët e dashnores së tij duke u puthur si të marrë. Të gjithë vetëm për këtë flasin... Partitë e opozitës kërkojnë të japë dorëheqjen, bashkëpunëtorët e tij politikë denoncojnë linçimin puritan, ndërsa populli ka mendime të ndryshme. Gjithsesi, edhe nëse nuk e humb postin, autoritetin ia mori lumi.

A u mor vesh kjo gjë në Francë? Ç'mendon për këtë?

Luiza

A ka faj për tradhti bashkëshortore?

Jo, faji i tij është martesal

Si mund të dalim para bashkiakut ose priftit dhe të betohemi që s'do të prekim kurrë me dorë një grua tjetër veç sonës? Kush burrë me mend do ta bënte këtë betim po të mos ishte i detyruar?

Mua më tmerrojnë martesat me betimet e tyre për besnikëri, jo tradhtia, që më duket një zgjim i shëndetshëm i natyrës.

Adami

P.S. Po, kemi folur shumë për kryeministrin tuaj këtu. Në thelb, aq na bën për fatin e tij, por ky rast na jep mundësinë të kuptojmë prirjet seksuale dhe morale të atyre që na rrethojnë. Na shërben si busull.

Adam,

Sot në mëngjes, shkova te fqinja ime, sa për të bërë një dorë muhabet dhe macja e saj më bindi që ti e more shumë lehtë çështjen e eliksirit të dashurisë.

Ruja - kështu e ka emrin macja - iu afrua një bime në vazo, ndaloi papritur, ngriti buzën e sipërme, pastaj duke marrë frymë me gojë, me ballin e mrrolur, me putrat e shtriquara zhyti turirin e saj rozë te lulja, teksa kraharori i fërgëllonte nga kërritje gjithnjë e më të forta, diçka mes endjes dhe rënkimit. Pas disa sekondave, filloi të rrotullohej rreth vetes si e tërbuar, me bishtin përpjetë, me sytë që i lëshonin xixa, duke gulçuar.

- Është mendër macesh, - më shpjegoi fqinja kur vuri re habinë time. - Ajo përzë insektet dhe tërheq macet.

ELIKSIRI I DASHURISË

Ruja mjaulliu fort, e acaruar që gjethet e gjelbra nuk i përgjigjeshin lajkave të saj.

- *Nepetalaktoni* nxit prodhimin e feromoneve seksuale në tru, është efekti i terpeninës¹, - sqaroi ajo, sikur të bëhej fjalë për një gjë që e dinin të gjithë.

Papritur, s'ë kuptova se çfarë më hutoi më tepër, sjellja e Rusë apo fjalori i fqinjës sime.

- Kjo lëndë eksiton edhe tigrat, - shtoi ajo.

- Po burrat?

- I vë në gjumë.

Me të thënë këtë fjalë, ia plasëm të qeshurit, ajo, sepse aq i bënte për burrat, ndërsa unë, sepse dola në përfundimin se çastet më të bukura dashurore ndodhin në ëndërr.

Në zyrë, duke përfituar nga pushimi i drekës, mbloodha ca të dhëna. Prej mijëvjeçarësh këshillohen pije magjike, ilaçe, parfume, lutje, rite, formula mistike; vetëm burimi ndryshon - mjekësia, feja, besëtytnia, magjia e bardhë, e kuqe apo e zezë. Ata fallxhorët e metrosë parisiane, që u shpërndajnë udhëtarëve fletëpalosje me këshilla se si të bëjnë për vete personin e dëshiruar ose se si të fitojmë sërish

¹ “Një lot tinëzar”, arie nga akti i dytë i operës së Gaetano Donizetit, “Eliksiri i dashurisë” (shën. i përkth.).

ELIKSIRI I DASHURISË

njeriun e zemrës, janë vazhdimi i një tradite sipas së cilës, ndjenjat nuk i lihen rastësisë. Kur biem në dashuri, ne biem në rrjetën - krahët - e tjetrit. Mbase një hile e ka kushtëzuar gremisjen tonë.

Vraje mendjen dhe më thuaj se ç'mendon.

Luiza

P.S. Si po ia çon? Më trego si i kalon ditët? A ke një grua tjetër në jetën tënde?